Paneli këshilldhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

OPINION

Data e miratimit: 26 nëntor 2010

Lënda nr. 02/08

Nexhmedin SPAHIU

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njëriut i përbërë nga antarët e mëposhtëm, më datë 26 nëntor, paraqet:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Ndihmuar nga:

Z. Rajesh TALWAR, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së lartshënuar, paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të 23 mars 2006, për themelimin e Panelit Këshillëdhësë për të Drejtat e Njëriut,

Pasi janë shqyrtuar me kujdes, paraqet të gjeturat dhe rekomandimet vijuese:

I. SEANCAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më datë 1 mars 2008 dhe regjistruar me datë 12 mars 2008.

2. Më 15 prill 2008 Paneli ia komunikoi ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) në pajtim me nenin 11.3 të Rregullores nr. 2006/12 të 23 marsit 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njëriut duke

kërkuar komentet në lejueshmërinë dhe bazueshmërinë e ankesës deri më 2 maj 2008. PSSP-ja nuk e shfrytëzoi këtë rast.

3. Më datë 16 korrik 2008, Paneli deklaroi se ankesa është e pranueshme.

4. Me letrën e datës 23 korrik 2008, PSSP-ja u informua për vendimin dhe kërkoi përgjigje për ankesën. Më 29 korrik 2008, PSSP-ja bëri komentet për lejueshmërinë e rastit. Ai u përmbajt në komentet e tij për bazueshmërinë. Paditësi iu përgjigj komenteve të PSSP-se me një letër të datës 10 tetor 2008.

5. Më 20 mars 2009 Paneli miratoi një vendim të një-anshëm me të cilin anuloi refuzimin e lejueshmërisë së ankesës. Poashtu vendosi të pezulloj hetimin e mëtutjeshem të bazueshmëriës së saj dhe urdhëroi të kontaktojë me Komisionin e Pavarur për Media për qartësimin e disa çështjeve.

6. Më 14 maj 2010 Paneli kontaktoi Komisionin e Pavarur për Media me qëllim që të marr ndonjë të dhënë përkatëse. Komisioni i Pavarur për Media u përgjigj më 3 qershor 2010 dhe i ofroi Panelit dokumente dhe komente në çështjet e ngritura për rastin.

7. Më 21 qershor 2010 Paneli ia komunikoi paditësit dhe PSSP-së komentet nga Komisioni i Pavarur për Media, dhe ftoi palët që të dërgojnë komentet e tyre. Paditësi u përgjigj me 12 korrik 2010. PSSP-ja u përgjigjj më 14 korrik 2010. Vërejtjet e UNMIK-ut, të cilat përmbanin komentet e para për bazueshmërinë e ankesës, iu komunikuan paditësit, i cili ishte ftuar të dërgonte komentet e tij. Paditësi u përgjigj më 30 korrik 2010.

II. FAKTET

8. Paditësi është drejtor i TV Mitrovica, një organizate transmetuese private në rajonin e Mitrovicës në Kosovë.

9. Më 27 prill 2005 Komisioneri i Përkohshëm për Media lëshoi vendimin për leje 2005/01, duke i dhënë TV Mitrovicës zgjerim të hapësirës së mbulimit. Në shtator 2005 TV Mitrovica filloi të transmetonte nga lokacionet e reja në Kodrën e Cernushës.

10. Më 20 dhjetor 2005 Komisioneri i Përkohshëm për Media lëshoi vendimin për leje 2005/01a, me të cilin ai përcaktoi se TV Mitrovica nuk i përmbushi kushtet e caktuara në vendimin e lejes 2005/01. Përmes kësaj ai refuzoi kërkesën e TV Mitrovicës për ta përmirësuar lejen, dhe urdhëroi që TV Mitrovica të kthehej në lokacionin e lejuar më parë në qendër të Mitrovicës, dhe të pajtohet me kushtet dhe kriteret teknike të aplikuara më parë, brenda shtatë ditëve.

11. Gjatë kontrollimit të rregullt të bërë nga Zyra e Komisionerit të Përkohshëm për Media, u zbulua se TV Mitrovica mbulonte një hapësirë më të gjerë se sa i lejohej me leje të punës. Më 12 janar 2006 Komisioneri i Përkohshëm për Media lëshoi një vendim sanksionues lidhur me ankesën nr. 2005/41. Ai gjeti shkelje të mëdha të kritereve dhe kushteve të lejes së dhënë në pajtim me vendimin për leje 2005/01 të 27 prillit 2005 dhe të vendimit për leje të përmirësuar 2005/01a të 20 dhjetorit 2005, dhe urdhëroi që të veprohet sipas vendimit të lejes së fundit.

12. TV Mitrovica u ankua. Me 8 mars 2006 Bordi i Ankesave për Media deklaroi se nuk ishte i kënaqur që TV Mitrovicës i ishte dhënë vendimi për leje 2005/01a. I anuloi ato pjesët e vendimit sanksionues të 12 dhjetorit 2006 të cilat ishin të bazuara në mospërputhje me vendimin për leje. Në të njëjtën kohë, mbështeti të gjeturat tjera të atij vendimi, përfshirë ato të bazuara në vendimin për leje 2005/01 të 27 prillit 2005.

13. Me 14 mars 2006, Komisioneri i Pavarur për Media lëshoi një vendim lidhur me ankesën nr. 2006/07. Në mënyrë që t'i përshtatet të gjeturave të vendimit të shënuar më lart të Bordit të Ankesave të Mediave, ai lëshoi përsëri vendimin për leje 2005/01a, dhe urdhëroi që të hyn në fuqi menjëherë. Në mënyrë që të sigurojmë përputhje me vendimet për leje 2005/01 dhe 2005/01a, Komisioneri i Përkohshëm për Media urdhëroi TV Mitrovicën që t'i dorëzojë atij pajisjet lidhëse të përdorura në trasmetimin e sinjalit nga Kodra e Cernushes, brenda shtatë ditëve.

14. TV Mitrovica u ankua. Më 20 gusht 2006, Bordi i Ankesa për Media urdhëroi që një ekspert të hetojë nëse ishte e mundur apo jo që teknikisht të punohet me hapësirat e kufizuara të caktuata në vendimin e lejes 2005/01. Dy ekspertë u caktuan për ta vlerësuar rastin. Ekspertët arritën në një përfundim të pavarur që teknikisht ishte e mundshme të punohet sipas lejes. Duke marrë parasysh mendimet e këtyre ekspertëve, më 27 nëntor 2006, Bordi i Ankesave të Mediave urdhëroi TV Mitrovicën që t'i kthejë sa më parë që është e mundshme antenat e tij në përputhje me lejen e tij, më së voni deri më 1 maj 2007. Nëse TV Mitrovica nuk vepron sipas këtij urdhri, leja do t'i merret automatikisht pas kësaj date.

15. Sipas paditësit, ai veproi sipas urdhërit të Bordit të Ankesave të Mediave duke e ndërruar drejtimin e antenave. Megjithatë, sipas zyres së Shefit Ekzekutiv të Komisionit të Pavarur të Mediave, i cili në ndërkohë kishtë marrë përsipër detyrat të Komisionerit të Përkohshëm të Mediave, TV Mitrovica vazhdonte të mbulonte hapësirë më të gjerë se sa i lejohej me leje. Zyra i dërgoi disa paralajmërime dhe vërejtje.

16. Në një letër dërguar TV Mitrovicës më datë 24 dhjetor 2007, shefi ekzekutiv i Komisionit të Pavarur të Mediave shprehu pikëpamjen e tij që, si rezultat i mos-përputhjes me vendimin e Bordit të Ankesave të Mediave, TV Mitrovica po transmetonte pa lejen e Bordit të Ankesave të Mediave. Ajo i paralajmëroi ata se po të kishte ndonjë ndërprerje të menjëhershme të transmetimit, pajisjet transmetuese do të konfiskoheshin.

17. Katër ditë më vonë, më datë 28 dhjetor 2007, shefi ekzekutiv urdhëroi konfiskimin e pajisjeve transmetuese të TV Mitrovicës. Urdhri përveç tjerash iu referua vendimit 2007/02 të Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 20 prill 2007, i cili i ngarkoi një varg përgjegjësishë shefit ekzekutiv, në veçanti përgjegjesinë për të vepruar dhe marrë vendime në rastet e transmetimeve pa leje apo ato ilegale. Urdhri u zbatua po atë ditë. Ky akt është rezultat i ankesës drejtuar Panelit.

18. Menjëherë pas konfiskimit, paditësi paraqiti një ankesë në Bordin e Ankesave për Media. Kjo ankesë u dërgua në Komisionin e Pavarur të Mediave. Bazuar në ligjin në fuqi, shefi ekzekutiv konsideroi që asnjë ankesë nuk është e mundshme kundër konfiskimit, dhe prandaj ajo nuk e dërgoi ankesën në Bordin e Ankesave për Media. Kështu, asnjë vendim nuk është marrë për këtë ankesë.

19. Pas një thirrje publike për tender nga Komisioni i Pavarur për Media për shpërdarjen e frekuencave në komunën e Mitrovicës, TV Mitrovica aplikoi për leje, bashkë me palët tjera të interesuara. Kushtet e lejes ofruan një hapësirë më të gjerë të mbulimit se sa ajo që ishte lejuar me lejen e vitit 2005. Më datë 7 nëntor 2008 i sapoformuari Këshilli i Komisionit të Pavarur të Mediave, lëshoi një leje të re për TV Mitrovicën. Si rrjedhojë, pajisjet e konfiskuara iu kthyen TV Mitrovicës.

III. ANKESA

20. Paditësi pohon në shkeljen e të drejtës se tij për gëzimin e pronës së tij, ashtu siç garantohet me nënin 17 (2) të Deklaratës Univerzale të të Drejtave të Njëriut (DNDN). Me vendimin e tij për pranueshmërinë, të datës 16 korrik 2008, Paneli vendosi që do ta analizonte ankesën poashtu sipas nenit 1 të Protokolit nr. 1. të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njëriut (KEDNJ).

IV. LIGJI

A. Argumentet e palëve

1. Paraqitjet e parashtresave

21. Në komentet e 30 korrikut 2010, në përgjigje të komenteve të UNMIK-ut të datës 14 korrik 2010, paditësi pohon se është e padrejtë që PSSP-ja nuk ishte në dijeni për situatën lidhur me vendimin e marrë nga Komisioni i Pavarur për Media në rastin e tij. Duke patur parasysh pozitën e TV Mitrovices në sy të mediave, UNMIK-u është dashur të jetë në dijeni për situatën. Për më tëpër, paditësi e kishte informuar PSSP-në drejtpërsëdrejti për situatën.

22. Lidhur me bazueshmërinë, paditësi paraqet në ankesën e tij dhe në komentet e tij të mëvonshme ndërhyrja për të cilën është ankuar, domethenë konfiskimi i pajisjeve, është urdhëruar nga shefi ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media, përderisa një vendim i tille i tejkaloi kompetencat e saj. Sipas paditësit është dashur të jetë Këshilli i Komisioni të Pavarur të Mediave, i përbërë nga shtatë antarë, e jo shefi ekzekutiv, që të vleresojë nëse TV Mitrovica kishte punuar në pajtim me vendimin e Bordit të Ankesave për Media të datës 27 nëntor 2006. Ai argumenton se shefi ekzekutiv mori vendim personal. Duke u bazuar në ketë ai tërheq vemendjen në faktin se leja e re e TV Mitrovicës, lëshuar nga Këshilli në vitin 2008, ofron më shumë hapësirë mbulimi se sa leja e mëhershme; për paditësin ky është një ilustrim i faktit që një Këshill i përbërë nga shtatë persona, mund të merr një vendim më të matur dhe ta nxjerrë një gjykim të paanshëm se sa një zyrtar ekzekutiv.

23. Se sa u mbështet shefi ekzekutiv në të drejtat e saj të dhëna nga Këshilli, paditësi argumenton që një ngarkim i detyrave të tilla ishte joligjor, meqenëse Këshilli nuk kishte të drejtë të caktojë detyra.

2. Parashtresat e UNMIK-ut

24. Në komentet e tij të datës 14 korrik 2010, UNMIK-u mbron pikëpamjen e vet, të shprehur në komentet e tij të datës 27 gusht 2008, që Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes, zyrtarët dhe agjencitë e tyre, janë të pavaruara nga detyrat e PSSP-së. Kjo është e vërtetë veçanarisht në lidhje me Komisionin e Pavarur të Mediave. Vendimet e tij (komisionit) nuk mund t'i ngakohen UNMIK-ut. Vendimet e marra në këtë rast nga Komisioni i Pavarur për Media nuk ishin të natyrës që PSSP-ja të ishte në dijeni për to që të mund të merrte masa korrigjuese. Po të kishte ndërhyrë PSSP-ja, ai do ta shkelte pavarësinë e dhënë Komisionit të Pavarur të Mediave, e poashtu edhe procedurat garantuese që i janë dhënë Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes.

25. Në lidhje me vendimin e Këshillit të Komisionit të Pavarur të Mediave të datës 20 prill 2007, që të ngarkojë detyrat e tij tek shefi ekzekutiv, UNMIK i referohet ngarkimit të përgjegjësisë si "zgjidhje e rastit, ashtu si janë në [nr. i udhëzimit 2006/04 të Këshillit] në aplikimin e lëshimit të lejeve". UNMIK-u poashtu i referohet nenit 3.11 dhe 3.12 të Ligjit me nr. 02/L-15 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 21 prill 2005 dhe të shpallur, me përmisime, nga PSSP-ja më 8 korrik 2005 (Ligji për Media). Sipas këtyre dispozitave është Këshilli që mund të lëshojë urdhra, përfshirë edhe konfiskimin e pajisjeve. UNMIK konstaton se "është e qartë nga dispozitat kryesore se Ligji i Mediave dhe legjislativi i tij synojnë që ngarkimi me detyra për të lëshuar urdhra, përfshirë edhe konfiskimin e pajisjeve, do të ishte në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Media, sidomos për shkak të (ndarjes) së detyrave në mes Këshillit, Bordit të Ankesave për Media dhe zyrës së (shefit ekzekutiv) të përshkruar me kujdes aty".

26. Sa i përket mbajtjes se pajisjeve të konfiskuara nga Komisioni i Pavarur për Media deri në lëshimin e lejës së re të TV Mitrovicës më datë 7 nëntor 2008, UNMIK-u tërheq vemendjen se TV Mitrovica mund të kishte marrë pajisjet e saj më herët por kishte provuar ta bindë Komisionin e Pavarur të Mediave se do ta kufizonte hapësirën në të cilën do të transmetonte, duke e mbajtur pezull mosmarreveshjen mes TV Mitrovicës dhe Komisionit të Pavarur të Mediave. Megjithatë, nuk duket se TV Mitrovica është përpjekur ta bëjë këtë.

27. UNMIK-u përfundon se nuk kishte shkelje të së drejtës së paditësit që ta gezonte pronën e tij.

B. Vlerësimi i Panelit

1. Sa i përket përgjegjësisë së UNMIK-ut

28. Paneli rikujton se ka shqyrtuar çështjen e përgjegjësisë së UNMIK-ut në mendimin e tij të njëanëshëm të datës 29 mars 2009. Ka gjetur se, edhe pse rasti i ngritur ka zanafillen nga Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse, UNMIK-u është përgjegjës për të. Elementet vendimtare në lidhje me këtë janë se UNMIK-u themeloi Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe se Komisioni ishtë një organ që operonte brenda Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme, lëshuar nga PSSP-ja, dhe se PSSP-ja, që mban përgjegjësinë ligjore në Kosovë, ishte në gjendje t'i rregullonte aktivitetet e saj dhe të korrigjonte ndonjë parregullsi në veprimet e tyre.

29. Është e vertetë se UNMIK-u nuk morri pjesë personalisht, përmes PSSP-së apo ndonjë zyrtari tjetër, në rastin e TV Mitrovicës. Për arsyet e cekura më lart, megjithatë, ky rast nuk shfajson UNMIK-un nga përgjegjësia e tij.

30. Si rezultat i kësaj, Paneli nuk sheh arsye të ndryshojë konkludimin e bërë në mendimin e tij të pjesshëm. Prandaj, konfirmon se UNMIK-u është përgjegjës për rastin e ngritur.

2. Sa i përket pohimit të shkeljes të së *drejtës për mbrojtje të pronës*

a. Vlerësimet e përgjithshme

31. Neni 17 i (DNDN), që paditësi i referohet, thotë me sa vjon:

> "1. Secili ka të drejtë të ketë pasuri personale dhe poashtu në shoqëri me të tjerët.
> 2. Askujt nuk do t'i merret me dhunë pasuria e tij".

32. Nëni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ, të cilin Paneli ka vendosur ta përfshijë në ketë vlerësim, thotë me sa vijon:

> "Cdo person fizik apo juridik ka të drejtë t'i gezojë pasuritë e tij. Askujt nuk do t'i merret e drejta për pasuritë e tij përveç në rast të interesit publik and si rezultat i kushteve të caktuara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të ligjit ndërkombëtar.
>
> Dispozitat e mëparshme nuk duhet, në asnjë mënyrë, të pengojnë të drejtën e një shteti për të zbatuar ligjet që i kosiderojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagesën e taksave ose të kontributeve të tjera ose të gjobave."

33. Paneli konsideron se të dyja dispozitat në thelb garantojnë të drejtën e njëjtë, që do të thotë të drejtën për mbrojtjen e pronës.

34. Konfiskimi i pajisjeve të transmetimit përbën një ndërhyrje në të drejtën e paditësit për mbrojtjen e pronës së tij. Kjo pikë nuk është kontestuese.

35. Sa i përket justifikimit të mundshëm të kësaj ndërhyrje, Paneli konsideron se kushtet e përcaktuara në nënin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ mund të aplikohen edhe në kontekstin e nenit 17 të DNDN.

36. Siç thekson vazhdimisht Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njëriut (GJEDNJ),

> "Neni 1 i Protokollit nr 1, i cili garanton në thelb të drejtën e pronës, përbëhet nga tri rregulla të veçanta (...): e para, e cila është e shprehur në fjalinë e parë të paragrafit të parë dhe është e një natyre të përgjithshme, parashtron parimin e gëzimit të qëtë të pronës. Rregulli i dytë, në fjalinë e dytë të paragrafit të njëjtë, mbulon ndalimin nga prona dhe e nënshtron atë ndaj kushtëve të caktuara. E treta, të përfshira në paragrafin e dytë, pranon se shtetet kontraktuese kanë të drejtë, ndër të tjera, për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Rregulla e dytë dhe e tretë, që merren me raste të veçanta të ndërhyrjeve në të drejtën për gëzimin e pronave, duhet të interpretohen në pikepamjen e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në

Rregullin e parë (...) "(shih, për shembull, GJEDNJ (Dhoma e Madhe), Depalle kundër Francës, nr. 34044/02, aktgjykimi i datës 29 mars 2010, § 77).

37. Urdhri nga Bordi i Ankesave për Media për TV Mitrovicën për të sjellë antenat e saj në përputhje me licencën e tij në mënyrë të qartë përbëntë një kontroll të përdorimit të pronës, në kuptim të paragrafit të dytë të nënit 1. 37.

38. Konfiskimi i pajisjeve të trasmetimit të TV Mitrovicës, ishtë një masë e marrë për zbatimin e urdhrit. Paditësi nuk e ka humbur pronësinë e tij mbi këtë pajisje. Siç shkruante në verejtjen për pajisjet e konfiskuara, 'pajisjet e konfiskuara [do] të mbahen nga ana e [Komisioni i Pavarur për Media] në vend të sigurt, që do t'i kthehen [paditësit] pas garancive të mjaftueshme se transmetimi ilegal [nuk] do të përsëritët". Parashtruesi i ankesës në fakt rimori pajisjet pas lëshimit të licencës së vitit 2008.

39. Si pasojë e kësaj konfiskimi shtoi kontrollin e përdorimit të pronës. Në lidhje me këtë, paragrafi i dytë i nënit 1 është i zbatueshëm në rastin në fjalë (shih GJEDNJ, AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar, aktgjykimi i 24 tetorit 1986, Publikimet e Gjykatës, Seria A, nr 108., fq 17-18, § § 50-51, GJEDNJ, Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar, të datës 5 maj 1995, Publikimet e Gjykatës, Seria A, nr 316 A, f. 15-16, § § 33-34)..

b. Në përputhje me kërkesat e nënit 1, paragrafi i dytë, i Protokollit 1 të KEDNJ

40. Kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nënit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ është se çdo ndërhyrje nga autoriteti publik me respektimin e pasurisë duhet të jetë e ligjshme. Në veçanti, paragrafi i dytë i nenit 1, duke arsyetuar se shtetet e kanë të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës, e kufizon të drejtën e tyre me kusht që ajo të ushtrohet me zbatimin e "ligjeve" (GJEDNJ (Dhoma), Huttën-Czapska k. Polonisë, nr. 3501/97, vendim i datës 19 qershor 2006, KEDNJ, 2006-VIII, § 163).

41. Çështja që shtrohet këtu është nëse Shefi Ekzekutiv i Komisionit të Pavarur për Media, kur ajo urdhëroi konfiskimin e pajisjeve të transmetimit, ka qenë ligjërisht përgjegjese për të marrë vendim të tillë.

42. 42. Është e rëndësishme të kujtojmë se, sipas nënit 2.3 të Ligjit për Media, Komisioni i Pavarur për Media përbëhet nga tri organe të veçanta, duke përfshirë edhe Këshillin dhe Zyren e Shefit Ekzekutiv. Këshilli është i përbërë nga shtatë anëtarë: pesë anëtarë vendorë të Kosovës të emëruar nga Kuvendi i Kosovës dhe dy anëtarë ndërkombëtarë të emëruar nga PSSP-ja (neni 4). Shefi Ekzekutiv emërohet nga Këshilli, pas një procesi të hapur dhe konkurrues (neni 9.2).

43. Ligji për media parashikon që Këshilli mund të lëshojë leje, dhe se ai ka fuqinë për të vënë sanksionë, me rekomandimin e Shefit Ekzekutiv, për shkelje të kushteve të lejes (nenet 3.11, 3.12 dhe 20.1). Për më tëpër, të rëndësishëm janë veçanërisht nenet 20.3 dhe 20.5, ku thuhet:

"20.3. Kur transmetuesi nuk e respekton sanksionin, Këshilli mund të marrë masa të nëvojshme të lejuara nga ligji i aplikueshëm për ta zbatuar këtë sanksion përmes Zyrës së Shefit Ekzekutiv.

.....

20.5. Pajisjet përkatëse për transmetim do të konfiskohen nga kushdo që operon pa Leje transmetuese valide. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa të Mediave. "

44. Funksionet e Këshillit janë të përshkruara në nenin 3 të Ligjit për Media, dhe ato të Zyrës së Shefit Ekzekutiv dhe ato të Shefit Ekzekutiv në nenet 8 dhe 9 të këtij Ligji. Në asnjë nga këto shkrime, ose në ndonjë artikull tjetër të Ligjit nuk përmendet mundësia e Këshillit që të delegojë ndonjë nga kompetencat e tij te Shefi Ekzekutiv.

45. Për më tëpër, ashtu siç thekson PSSP-ja në komentet e tij, Ligji për Media siguron një shpërndarje "të përshkruara me kujdes" të kompetencave në mes të Këshillit dhe të Zyrës së Shefit Ekzekutiv. Në mënyrë të veçantë në lidhje me vendosjen e sanksioneve, në ligj përmendet që Shefit Ekzekutiv mund t'i bëjë rekomandime, por se fuqia vendim-marrëse i është dhënë Këshillit.

46. Paneli konsideron se nga interpretimi i saktë dhe fryma e Ligjit për Media del se Këshilli i delegoi në mënyrë të paligjshme pushtetin e tij në lidhje me "lëshimin e vendimeve për të gjitha veprimet dhe vendimet lidhur me rastet e transmetimit të palicencuar - transmetimin ilegal" Shefit Ekzekutiv (2007/02 vendim i Këshillit të 20 prillit 2007), në mënyrë të veçantë që ky delegim është kuptuar që të përfshijnë kompetencën për të urdhëruar konfiskimin e pajisjeve të transmetimit. Paneli vëren se PSSP-ja pajtohet se delegimi i tillë i pushtëtit ishte i paligjshëm.

47. Meqenëse vendimi për konfiskim i lëshuar nga Shefi Ekzekutiv më 28 dhjetor 2007 ishte i bazuar në një ngarkim të paligjshëm të pushtetit tek ajo, Paneli mund të përfundon se Shefi Ekzekutiv nuk ishte ligjërisht përgjegjës, dhe se për këtë arsye urdhri ishte i paligjshëm. Në këtë mënyrë vendimi nuk i plotësoi kërkesat e para të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ (shih më sipër, § 40).

48. Ky konstatim se ndërhyrja nuk ishte e ligjshme e bën të panevojshme për të shqyrtuar aspekte të tjera sipas nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, duke përfshirë edhe nëse është bërë një ekuilibër i drejtë në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesat e mbrojtjes së të drejtave themelore të individit.

49. Për arsyet e mësipërme, Paneli konsideron se ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ dhe nenit 17 të UDHR për shkak të mungesës së kompetencës ligjore të Kryeshefit Ekzekutiv për lëshimin e urdhrit për konfiskim ndaj TV Mitrovicës.

50. Ky përfundim e bën të panevojshem për të shqyrtuar nëse të drejtat e paditësit kanë qënë gjithashtu të shkelura për shkak të refuzimit nga ana e Kryeshefit të paraqesë ankesën e tij në Bordin e Ankesave për Media.

V. REKOMANDIMET

51. Në ankesën e tij paditësi i ka kërkuar Panelit që t'i rekomandojë PSSP-së për të anuluar vendimin e Shefit Ekzekutiv dhe të urdhërojë Komisionin e Pavarur për Media që atij t'ia kthejë pajisjet.

52. Duke pasur parasysh pavarësinë e Komisionit të Pavarur për Media në lidhje me PSSP-në, nuk do të jetë e përshtatshme për Panelin që të rekomandojë anulimin e një vendimi të marrë nga Komisioni. Sido që të jetë, aktualisht PSSP-ja nuk ushtron ndonjë pushtet që do të bëjë të mundur të ndërhyjë në aktivitetet e Komisionit.

53. Sa i përket kthimit të pajisjeve, Paneli vë në dukje se nuk ka më asnjë nevojë për të rekomanduar një gjë të tillë, pasi tashmë paditësi i ka marrë ato.

54. Paneli konsideron të nevojshëm për të shqyrtuar, sipas detyrës zyrtare, nëse kërkohen masa të tjera riparimi.

55. Paneli kujton në lidhje me këtë se duket se akti i ngritur ishte marrë nga një organ i Komisionit të Pavarur për Media-Shefit Ekzekutiv që nuk kishte kompetencë për të marrë një masë të tillë. Paneli nuk mund të spekulojë mbi atë po qe se çështja do të shqyrtohej nga Këshilli nuk do të ishte marrë asnjë vendim apo do të ishte marrë vendim tjetër. Paneli për më tëpër vë re se në ndërkohë pajisjet e konfiskuara i janë kthyer paditësit. Prandaj nuk rekomandon ndonjë dëmshpërblim për dëmin pasuror.

56. Fakti mbetet që vendimi në lidhje me konfiskimin e pajisjeve të transmetimit, sipas mendimit të Panelit, nuk ishtë në përputhje me KEDNJ-në dhe UDHR. Paneli konsideron se pranimi nga UNMIK-u se ka ndodhur një shkelje do të përbënte një formë të përshtatshme të kompensimit për çdo dëm jo-material që mund të ketë qenë bërë nga paditësi.

PËR KETO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. KONSTATON SE KA PASUR NJË SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE TË NENIT 17 TË DEKLARATËS UNIVERSALE TË TË DREJTAVE TË NJËRIUT;

2. REKOMADON:

   A. QË PËRFAQËSUESI SPECIAL I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM NË EMËR TË UNMIK-UT PRANON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJËRIUT DHE TË NENIT 17 TË DEKLARATËS UNIVERSALE TË TË DREJTAVE TË NJËRIUT, SIÇ THUHET NË PARAGRAFIN 56 MË SIPËR;

   B. QË UNMIK-u TA INFORMON PADITËSIN DHE PANELIN PËR ZBATIMIN E KËTIJ REKOMANDIMI.

Rajesh TALWAR
Zyrtar Ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar